



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/148  
Datë: 30.06.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4 dhe të nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/ 2011, dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për hartimin e Programit për Reforma Ekonomike 2018-2020**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës përgatitë Programin për Reforma Ekonomike 2018-2020 (në vijim PRE), si pjesë e dialogut ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës në kuadër të qeverisjes ekonomike.
2. PRE mbulon periudhën afatmesme tri vjeçare 2018-2020 dhe bazohet në kornizën makro-fiskale, prioritetet e reformave strukturore dhe masat përkatëse që janë pjesë e Programit të Qeverisë 2015-2018 dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021.
3. Duke u bazuar në Udhëzimet e Komisionit Evropian, përmes Programit për Reforma Ekonomike raportohet për zbatimin e rekomandimeve nga Konkluzionet e përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar në mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë të datës 23 maj 2017.
4. Ministri i Financave koordinon procesin e hartimit të PRE në cilësinë e Koordinatorit Nacional të Programit për Reforma Ekonomike.
5. Koordinatori Nacional i Programit për Reforma Ekonomike mbështetet nga:
  - 5.1. Zyra për Planifikim Strategjik e Zyrës së Kryeministrit (ZPS) për agjendën e reformave strukturore, që përfshijnë politikat publike sipas fushave të përcaktuara me udhëzimet e Komisionit Evropian;
  - 5.2. Departamenti për Politika Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar (Ministria e Financave) lidhur me kornizën makro-ekonomike dhe politikat fiskale, duke përfshirë masat mbështetëse fiskale;
  - 5.3. Ministrinë e tjera të linjës në varësi të temave që trajtohen në PRE.

6. Sipas udhëzimeve të Koordinatorit Nacional, ZPS fton ministrinë e linjës dhe institucionet tjera sipas fushave të përcaktuara me Udhëzuesin e Komisionit Evropian për të kontribuar në procesin e hartimit dhe takimet e punës së Programit për Reforma Ekonomike.
7. Sipas fushave të përcaktuara nga Komisioni Evropian, Koordinatorin Nacional, me propozim të ministrive/institucioneve përkatëse, emëron koordinatorët sektorial, të cilët janë përgjegjës të hartojnë agjendën e reformave në fushat e tyre përkatëse sipas udhëzimeve të Komisionit Evropian, në veçanti për fushat:
  - 7.1. Menaxhimi i Financave Publike;
  - 7.2. Tregu i Energjisë, Transportit dhe Telekomunikacionit;
  - 7.3. Zhvillimet sektoriale;
  - 7.4. Mjedisi biznesor dhe zvogëlimi i ekonomisë informale;
  - 7.5. Hulumtimi, zhvillimi dhe inovacioni (HZHI) dhe Ekonomia Digjitale;
  - 7.6. Tregtia e jashtme dhe lehtësimi i investimeve;
  - 7.7. Arsimi dhe shkathtësitë;
  - 7.8. Punësimi dhe Tregu i punës;
  - 7.9. Përfshirja sociale, ulja e varfërisë dhe mundësitë e barabarta.
8. Duke u bazuar në këtë vendim, ZPS në koordinim me Koordinatorin Nacional për PRE do të përgatis një kalendar të procesit të hartimit të PRE-së dhe do ta ndajë atë me ministrinë përkatëse.
9. Prioritizimi i masave të Programit për Reforma Ekonomike 2018-2020, pasi që masat të përgatiten nga koordinatorët sektorial dhe shqyrtohen nga Zyra për Planifikim Strategjik, do të bëhet nga Komisioni për Planifikim Strategjik.
10. Drafti final i Programit për Reforma Ekonomike 2018-2020 aprovohet nga Komisioni për Planifikim Strategjik para se të dërgohet për miratimin përfundimtar në Qeveri.
11. Koordinatorin Nacional e prezanton draftin e PRE-së për konsultim të jashtëm me partnerët social, komunitetin e bizneseve, asociacionet dhe sindikatat, shoqërinë civile, pushtetin lokal dhe komisionet përkatëse parlamentare.
12. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/148  
Datë: 30.06.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafi 4 të Ligjit nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Plani vjetor i statistikave zyrtare për vitin 2018.
2. Agjencia e Statistikave të Kosovës është e obliguar që pjesën e implikimeve financiare të këtij Plani ta harmonizojë me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018.
3. Obligohet Agjencia e Statistikave e Kosovës për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/148  
Datë: 30.06.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i parcelës kadastrale nr. 1305-0, Zona kadastrale Zubin Potok, e cila preket nga ndërtimi i Stacionit Policor në Komunën e Zubin Potokut, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarin e pronës së paluajtshme, pozitën e saj në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqes së saj, e cila tabelë është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave.
4. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/148  
Datë: 30.06.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5 të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për t'i rekomanduar Presidentit të Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Financave për nënshkrimin e "Marrëveshjes për Financim shtesë për Projektin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural" ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit Ministrit të Financave për nënshkrimin e marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/148  
Datë: 30.06.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjet nr.03/L-221, nr. 04/L-116; nr. 04/L-194; nr. 05/L-063, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 342,000 (treqindedyzetedy mijë) euro, për nevojat e Doganës së Kosovës.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria e shpenzimeve të Rezervës, nën kategoria ekonomike e Rezervës me kod 38010 dhe transferohen në Ministrinë e Financave me kod 201, në nën programin Dogana e Kosovës me kod 13300, kategoria e shpenzimeve e mallrave dhe shërbimeve, nën kategoritë ekonomike si në vijim:
  - Tiketatat siguroese (banderolat), me kod 13680 në shumë prej 235,000 euro
  - Qiraja për përdorime tjera të hapësirave, me kod 14150 në shumë prej 72,000 euro
  - Shërbimet kontraktuese tjera, me kod 13460 në shumë prej 35,000 euro.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/148  
Datë: 30.06.2017


Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për kompensimin e shtesave dhe stimulim financiar për 85 gjyqtarë të krimeve të rënda për vitin 2017, në shumë prej 321,300 (treqindnjëzetënjë mijë e treqind) euro. Shtesa mujore për gjyqtarët e lartpërmendur është treqind (300) euro. Mjetet ndahen sipas nën-programeve si në vijim:
  - 1.1. Gjykata Supreme dhe Dhoma e Posaçme me kod 31600 shuma prej 45,360 euro kategoria ekonomike e Paga dhe Mëditje, nën kategoria shtesat dhe kompensimet tjera me kod 11155, për 12 gjyqtarë.
  - 1.2. Gjykata e Apelit me kod 38000 shuma prej 34,020 euro kategoria ekonomike e Paga dhe Mëditje, nën kategoria shtesat dhe kompensimet tjera me kod 11155, për 9 gjyqtarë.
  - 1.3. Gjykata Themelore në Prishtinë me kod 38100 shuma prej 79,380 euro kategoria ekonomike e Paga dhe Mëditje, nën kategoria shtesat dhe kompensimet tjera me kod 11155, për 21 gjyqtarë.
  - 1.4. Gjykata Themelore në Prizren me kod 38200 shuma prej 26,460 euro kategoria ekonomike e Paga dhe Mëditje, nën kategoria shtesat dhe kompensimet tjera me kod 11155, për 7 gjyqtarë.
  - 1.5. Gjykata Themelore në Gjiilan me kod 38300 shuma prej 30,240 euro kategoria ekonomike e Paga dhe Mëditje, nën kategoria shtesat dhe kompensimet tjera me kod 11155, për 8 gjyqtarë.
  - 1.6. Gjykata Themelore në Ferizaj me kod 38400 shuma prej 26,460 euro kategoria ekonomike e Paga dhe Mëditje, nën kategoria shtesat dhe kompensimet tjera me kod 11155, për 7 gjyqtarë.

- 1.7. Gjykata Themelore në Pejë me kod 38500 shuma prej 26,460 euro kategoria ekonomike e Paga dhe Mëditje, nën kategoria shtesat dhe kompensimet tjera me kod 11155, për 7 gjyqtarë.
- 1.8. Gjykata Themelore në Gjakovë me kod 38600 shuma prej 26,460 euro kategoria ekonomike e Paga dhe Mëditje, nën kategoria shtesat dhe kompensimet tjera me kod 11155, për 7 gjyqtarë.
- 1.9. Gjykata Themelore në Mitrovicë me kod 38700 shuma prej 26,460 euro kategoria ekonomike e Paga dhe Mëditje, nën kategoria shtesat dhe kompensimet tjera me kod 11155, për 7 gjyqtarë.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi janë të planifikuara në ndarjet buxhetore të pagave dhe mëditjeve për vitin 2017 në organizatën buxhetore Këshillin Gjyqësor të Kosovës me kod 328, në nën programet e lartcekura si në pikën 1.
3. Obligohet Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/148  
Datë: 30.06.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë 03/104 i datës 10 gusht 2016 i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr. 14/122 të datës 23 dhjetor 2016.
2. Ndryshimi nga pika 1. e këtij Vendimi ka të bëjë me fillimin e mbledhjes së premiumeve për sigurimin shëndetësor të obligueshëm për të gjithë qytetarët dhe banorët e Republikës së Kosovës të përcaktuar me Vendimin e Qeverisë nr. 14/122 të datës 23 dhjetor 2016, kështu që data 1 korrik e vitit 2017 ndryshohet si në vijim "shtyhet deri në aprovimin e Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, si dhe aktëve tjera nënligjore që derivojnë nga ky ligj.
3. Ky Vendim paraqet pjesë përbërese të Vendimit të Qeverisë nr. 03/104 të datës 10 gusht 2016 dhe Vendimit nr. 14/122 të datës 23 dhjetor 2016.
4. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 08/148  
Datë: 30.06.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5 të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për t'i rekomanduar Presidentit të Republikës së Kosovës për autorizimin e Ministrit të Financave për nënshkrimin e "Marrëveshjes për Financim për Projektin e Konkurrueshmërisë dhe gatishmërisë për eksport" ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit Ministrit të Financave për nënshkrimin e marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeminister i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 09/148  
Datë: 30.06.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 17 paragrafi 1. të Ligjit nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti i Punës të Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar për vitin 2016.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë